



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 381
Datë: 4/3/2022


Rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 28, paragrafi 1.6 të Statutit të UP-së dhe nenin 6 të Rregullores nr. prot. 1/131, datë 1.6.2015 të punës së Senatit të UP-së, thërret mbledhjen e njëzet e pestë (XXV) të Senatit të Universitetit të Prishtinës, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes XXIV të Senatit të UP-së, mbajtur me datë 24.1.2022;
2. Miratimi i propozimit të Këshillit të Fakultetit Ekonomik për zgjedhjen e prodekanëve: 1. Prof. dr. Drita Konxheli Radoniqi - prodekane për mësim dhe çështje financiare, 2. Prof. ass. dr. Alban Elshani - prodekan për çështje financiare dhe 3. Prof. dr. Afërdita Berisha - prodekane për kërkime shkencore dhe bashkëpunim ndërkombëtar;
3. Shqyrtimi i kërkesës së Prof. asoc.dr. Musa Selimi, dekan i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, për lirim me pagesë nga procesi mësimor për gjashtë (6) muaj të Dr. sc. Faton Tishukaj, asistent mësimor, me qëllim të përmbushjes së obligimeve si bursist në Universitetin e Konektikatit (SHBA) në kuadër të programit Fulbright;
4. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me propozimet e njëjësive akademike për pranimin e studentëve në studime të doktoratës për vitin akademik 2021/2022, të trajtuara në KQSD;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimeve të KQSD-së për lejimin e temave të doktoratës dhe të mentorëve, sipas raportit të KQSD-së;
6. Shqyrtimi i kërkesave për ratifikim të punimeve të doktoratës, sipas raportit të KQSD-së;
7. Formimi i komisionit për hartimin e rregullores për vlerësimin e performancës së personelit akademik;
8. Plotësimi i përbërjes së Komisionit për ankesa dhe parashtresa me një (1) anëtar të ri;
9. Shqyrtimi dhe vendosja lidhur me raportet e Komisionit për ankesa dhe parashtresa të Senatit;
10. Njoftimi për zëvendësimin nga Parlamenti Studentor i UP-së të anëtarëve në Komisionin për studime nga radhët e studentëve.
11. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet ditën e hënë, më datë 7.3.2022, me fillim prej orës 10:00.

P.S.: Në zbatim të masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19, të pranishmit obligohen t'i mbajnë maskat dhe ta ruajnë distancën fizike nga njëri-tjetri.

Kryesues i Senatit të UP-së

Prof. dr. Naser Sahiti, rektor

